


FOL

Raport përmbledhës për Anonimizimin e Aktgjykimeve të Gjykatave



Raport përmbledhës për Anonimizimin e Aktgjykimeve të Gjykatave

Titulli: Raport përmbledhës për Anonimizimin e Aktgjytimeve të Gjykatave

Autor: Lëvizja FOL

Viti i botimit: 2024

Publikuar nga: Lëvizja FOL

Andrea Gropa nr.35 Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org

+383 (0)49 131 542

Të drejtat e autorit © 2024. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

*Ky projekt mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan, përmes Byrosë Ndërkombëtare për Çështje të Narkotikëve dhe Sundim të Ligjit (INL).

*Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Lëvizjes FOL dhe nuk i pasqyron pikëpamjet e Departamentit të Shtetit Amerikan.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	6
Hyrje.....	7
Anonimizimi i Aktgjykimeve të Gjykatave në Kosovë.....	9
Kushtetuta e Republikës së Kosovës	9
Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.....	10
Ligji për Gjykatat	11
Kodi i Procedurës Penale (2022)	11
Publikimi i aktgjykimeve	14
Mos publikimi i aktgjykimeve	14
Anonimizimi i aktgjykimeve	15
Rekomandime	18
Rekomandimet në Fushën Penale	18
Rekomandimet në Fushën Civile	19
Rekomandimet në Fushën Administrative	19
Rekomandimet në Fushën Ekonomike (Komerciale)	19

Përmbledhje ekzekutive

Për një periudhë të gjatë Lëvizja FOL ka qenë e fokusuar në monitorimin e publikimit të aktgjykimeve të gjykatave në Kosovë, ku në bazë të këtij monitorimi janë bërë shumë publikime në këtë fushë. Në të njëjtën kohë, impakti i drejtpërdrejtë i monitorimit të publikimit të aktgjykimeve ka qenë amplifikimi në masë tejet të madhe të aktgjykimeve të publikuara. Megjithatë, përgjatë monitorimit të aktgjykimeve është vërejtur se publikimi i aktgjykimeve, përveç disa çështjeve teknike¹ ka disa mangësi dhe të meta të cilat do të adresohen në këtë raport.

Këto të meta dhe mangësi kanë të bëjnë pikërisht me (mos) anonimizimin e të dhënave në aktgjykime. Për këtë qëllim, Lëvizja FOL ka ndërmarrë këtë aktivitet për të evidentuar dhe për të analizuar çështjet që kanë të bëjnë me anonimizimin e aktgjykimeve nga ana e gjykatave të Kosovës.

Ky raport përmbledhës synon të bëjë një analizim gjithëpërfshirës të legjislacionit vendas në raport me praktikën e anonimizimit të aktgjykimeve dhe të diskutojë çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale, në një anë, dhe detyrimit që ka gjyqësori për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie në zhvillimin e proceseve gjyqësore, në anën tjetër.

Objektivi kryesor i këtij raporti është të mundësojë një vlerësim të kornizës ekzistuese ligjore sa i përket anonimizimit të vendimeve gjyqësore dhe vendosjen në një raport të drejtë të tre aspekteve kryesore: transparencës, privatësisë dhe administrimit të drejtë të drejtësisë në Kosovë. Një theks i veçantë do të vendoset në vlerësimin e shkallës në të cilën kuadri ligjor aktual qëndron në harmoni dhe sa kryqëzohet me parimet e transparencës, konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave.

Në fund, raporti do të propozojë rekomandime specifike për përmirësimin e politikave dhe praktikave aktuale, në mënyrë që të sigurohet një balancë më e mirë midis mbrojtjes së privatësisë së individëve si dhe nevojës për transparencë në procesin gjyqësor, posaçërisht në raport me kërkesat ligjore.

¹ Lëvizja FOL ka evidentuar raste ku aktgjykime të fushës civile, indeksohen si penale, apo kur lëndët e gjyqararit pas transferimit ose avancimit në gjykatë tjetër, barten me të në gjykatë të re dhe nuk ngelin të indeksuara në Gjykatën ku janë shqyrtuar lëndët, etj.

Hyrje

Në epokën digjitale mbrojtja e të dhënave personale paraqet një nga sfidat më të rëndësishme, pasi si individët ashtu dhe organizatat apo kompanitë veprojnë brenda një fushe delikate ku shfrytëzimi i përfitimeve që sjell avancimi i teknologjisë dhe mbrojtja e privatësisë janë në një konflikt të vazhdueshëm. Në këtë drejtim, anonimizimi i vendimeve të gjykatës përbën një aspekt kritik të mbrojtjes së të drejtave të privatësisë, duke kërkuar zbatim të kujdesshëm të politikave që vendosin në një raport të drejtë kërkesat rreth transparencës së procedurave gjyqësore dhe nevojave për të anonimizuar ose kufizuar qasjen në informacione të ndjeshme personale, duke siguruar kështu, në epokën e avancimit të shpejtë teknologjik, një sistem gjyqësor të drejtë dhe të hapur.

Anonimizimi i aktgjykimeve i referohet procesit të heqjes ose fshehjes së informacionit të caktuar të ndjeshëm ose privat nga teksti i një aktgjykimi para se ai të i vihet në dispozicion të publikut. Qëllimi i anonimizimit është të mbrojë privatësinë dhe konfidencialitetin e individëve të përfshirë në çështje gjyqësore si dhe të respektojë detyrimet ligjore dhe etike sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale. Informacioni specifik që anonimizohet mund të ndryshojë në varësi të natyrës së çështjes gjyqësore, por që zakonisht të dhënat që anonimizohen përfshijnë të dhëna identifikuese personale si: emrat, adresat, numrat personal, numrat e llogarive financiare dhe informacione të tjera të ndjeshme që mund të çojnë në identifikimin e individëve të përfshirë.

Qëllimi i anonimizimit është të vendosë një ekuilibër midis transparencës në sistemin e drejtësisë dhe mbrojtjes së të drejtave të privatësisë së individëve. Duke anonimizuar disa detaje, aktgjykimet mund të bëhen publike, dhe kështu minimizojnë rrezikun e dëmtimit ose keqpërdorimit të informacionit personal.

Anonimizimi i aktgjykimeve është i rëndësishëm për disa arsye. Së pari, ai ndihmon në mbrojtjen e privatësisë dhe identitetit të individëve të përfshirë në procedurat gjyqësore. Së dyti, anonimizimi promovon drejtësinë dhe paanshmërinë në sistemin e drejtësisë duke parandaluar paragjykimet që mund të lindin nga njohja e identiteteve, prejardhjes ose karakteristikave të individëve të përfshirë. Për më tepër, anonimizimi edhe pse kufizon të dhënat personale megjithatë është në funksion të transparencës dhe kontribuon në ngritjen besimit të publikut në sistemin ligjor përmes qasjes në aktgjykime nga ana e publikut gjithmonë duke ruajtur privatësinë. Për fund, anonimizimi vendos një ekuilibër midis llogaridhënies dhe mbrojtjes së informacionit personal.

Nuk ka ndonjë listë gjithëpërfshirëse të shteteve ku aktgjykimet janë publike me të gjitha të dhënat personale të zbuluara, sepse vende të ndryshme kanë ligje dhe praktika të ndryshme në lidhje me publikimin dhe anonimizimin e gjykimeve.

Megjithatë, disa shembuj të vendeve ku të dhënat personale përfshihen në aktgjykime janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës² ku të dhënat gjyqësore janë përgjithësisht publike, përveç rasteve kur mbyllen ose kufizohen nga ligje të veçanta ose me urdhër të gjykatës. Aktgjykimet në Mbretërinë e Bashkuar³ janë përgjithësisht të qasme për publikun dhe të dhënat personale mund të përfshihen nëse nuk ka arsye specifike për mbyllje ose kufizim.

Është e rëndësishme të theksohet se edhe në vendet ku aktgjykimet janë në një shkallë më të lartë në dispozicion për publikun, shpesh ekzistojnë udhëzime dhe procedura për të mbrojtur informacionin e ndjeshëm personal dhe për të respektuar të drejtat e privatësisë. Këto udhëzime synojnë të balancojnë të drejtën e publikut për qasje në informacion me nevojën për të mbrojtur të dhënat personale.

2 Qasja digjitale e aktgjykimeve, www.uscourts.gov/statistics-reports/accessing-court-documents-journalists-guide
Dokumentet që nuk janë të disponueshme për publikun përcaktohen në aktin që rregullon dokumentet dhe seancat dëgjimore të mbyllura. Megjithatë, edhe në dokumentet publike të gjykatës, disa informacione nuk janë të disponueshme. Rregullat federale kërkojnë që kushdo që paraqet një dokument të gjykatës federale duhet të redaktojë disa informacione personale në interes të privatësisë, duke përfshirë sigurimet shoqërore ose numrat e identifikimit të tatimpaguesit, datat e lindjes, emrat e fëmijëve të mitur, informacionet e llogarisë financiare dhe në raste penale, adresat e shtëpisë.

3 <https://www.judiciary.uk/about-the-judiciary/judiciary-and-data-protection-privacy-notice/>

Të dhënat personale të përpunuara nga sistemi gjyqësor duke ushtruar funksione gjyqësore mund të publikohen në urdhrat ose vendimet gjyqësore të gjykatave ose tribunaleve. Kjo është e nevojshme në interes të publikut për administratën e drejtësisë. Është e nevojshme për të lejuar individët të kuptojnë të drejtat dhe obligimet e tyre, që është një aspekt i sundimit të ligjit.

Publikimi i vendimeve është gjithashtu një kërkesë e parimeve kushtetuese të drejtësisë së hapur dhe është një mjet i nevojshëm për të mbështetur sundimin e ligjit. Si të tillë, është në interes të publikut.

Një gjykatë, ku është me doemos e nevojshme në interes të administratës së drejtësisë, mund të vendosë kufizime mbi të dhënat personale, si emrin e një individi, i cili vendoset në një vendim gjykate. Ajo gjithashtu mund të mbajë procedurat ligjore të mbyllura për publikun dhe të vendosë kufizime në qasjen në dosjet e gjykatave dhe tribunaleve. Vendimet e tilla merren nga gjykatësit brenda procedurave gjyqësore.

Anonimizimi i Aktgjytimeve të Gjykatave në Kosovë

Republika e Kosovës ka një kuadër ligjor mjaft të avancuar sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale. Në këtë pjesë të këtij raporti, do të shqyrtohet shkurtimisht kuadri ligjor, duke filluar nga Kushtetuat e Kosovës e deri të ligjet dhe aktet tjera nënligjore, që rregullojnë fushën e (mos) anonimizimit të vendimeve gjyqësore në Kosovë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Ngjashëm me shtetet e tjera evropiane, Kosova ka treguar kujdes të lartë ndaj ruajtjes dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Ky përkushtim është manifestuar përmes përfshirjes së mekanizmave mbrojtës në Kushtetutën e saj, e cila i garanton çdo individ të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Kushtetuta specifikon se mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe përdorimi i të dhënave personale duhet të rregullohen në mënyrë të përpiktë me ligj.

Neni 36 [E Drejta e Privatësisë] i Kushtetutës⁴ është në përputhje me kërkesat që dalin nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Personave Lidhur me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, që ndryshe njihet edhe si "Konventa 108". Ky është një traktat i miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 1981 që synon të mbrojë të

drejtën e privatësisë së individëve, duke marrë parasysh rrjedhën në rritje përtej kufijve të të dhënave personale që i nënshtrohen përpunimit automatik. Rishtazi, kjo Konventë është plotësuar që t'i përballojë sfidave bashkëkohore që dalin nga përpunimi automatik i të dhënave personale si dhe ka publikuar një Udhërrëfyes në lidhje me përpunimin automatik nga Inteligjenca Artificiale.⁵

Në këtë drejtim edhe praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vendimet e së cilës janë të obligueshëm që të merren në konsideratë nga gjykatat e Kosovës, kanë një numër të madh të çështjeve ku kanë adresuar shkeljen e të drejtave të privatësisë që nga përpunimi i të dhënave sa i përket të dhënave shëndetësore, të dhënave të lëvizjeve të individit, të dhënave në lidhje me ADN-në dhe gjurmët e gishtërinjve, etj.⁶

Në lidhje me nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës duhet potencuar se paragrafi i fundit (paragrafi 4) i këtij neni rregullon mbrojtjen e të dhënave personale, i cili përcakton se "[s]ecili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj." Pra, edhe pse garancitë për mbrojtjen e të dhënave personale janë vendosur në Kushtetutë, prapë se prapë Kushtetuta përcakton se vetëm me ligj mund të rregullohet grumbullimi,

4 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

5 Këshilli i Evropës, Komisioni Konsultativ i Konventës për Mbrojtjen e Individëve Lidhur me Përpunim Automatik të të Dhënave Personale, 2019, <https://rm.coe.int/guidelines-on-artificial-intelligence-and-data-protection/168091f9d8>

6 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Lista e çështjeve më të rëndësishme gjyqësore, Factsheet – Personal Data Protection, Shkurt 2024, https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/FS_Data_ENG

mbajtja, qasja, përmirësimi dhe shfrytëzimi i të dhënave për personin. Për këtë qëllim, Kosova ka nxjerr edhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale që do të analizohet në vijim.

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave në Kosovë,⁷ i miratuar në vitin 2019, paraqet një instrument kyç ligjor që trajton mbrojtjen e të dhënave personale dhe synon të sigurojë procesimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të individëve.

Ky ligj përshkruan në mënyrë të detajuar subjektet që i nënshtrohen, e që shtrihen si në sektorin publik dhe në atë privat, si dhe kategoritë e të dhënave që gëzojnë mbrojtje ligjore. Në thelb të këtij ligji qëndrojnë parimet themelore të mbrojtjes së të dhënave që shërbejnë si udhëzues për veprimet e procesimit të të dhënave. Këto parime përfshijnë ligjshmërinë, transparencën dhe integritetin, si dhe vë në theks rëndësinë e praktikave etike dhe të përgjegjshme të trajtimit të të dhënave. Në të njëjtën kohë, ligji vendos obligime substanciale për kontrolluesit dhe procesorët e të dhënave, duke detyruar zbatimin e masave të sigurisë të forta, marrjen e miratimit të nevojshëm për veprimet e procesimit të të dhënave, dhe njoftimin e menjëhershëm të shkeljeve të të dhënave kur është e nevojshme. Këto dispozita nënvizojnë rëndësinë e masave proaktive për të zvogëluar rrezikun dhe për të mbrojtur konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave personale.

Sipas këtij ligji, të dhënat personale përkufizohen si çdo informacion që i përket një personi fizik të identifikuar ose të identifikueshëm. Një person fizik i identifikueshëm karakterizohet si një individ që mund të dallohet drejtpërdrejt ose indirekt, me theks të veçantë përmes të

dhënave siç janë emri, numri identifikues, të dhënat e vendbanimit, karakteristikat fizike, mendore, statusin ekonomik, kulturor ose social të personit fizik në fjalë.

Për më tepër, ky ligj i referohet "pseudonimizimit" që përfshin përpunimin e të dhënave personale në një mënyrë që nuk i atribuohet më një subjekti specifik të të dhënave pa përdorimin e informacionit shtesë. Ky informacion shtesë duhet të mbahet i dallueshëm dhe t'i nënshtrohet masave teknike dhe organizative për të garantuar që të dhënat personale të mos i atribuohen çdo personi fizik të identifikuar ose të identifikueshëm.

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave në Kosovë vendos një autoritet mbikëqyrës të dedikuar i cili është i detyruar të monitorojë dhe të zbaton respektimin e rregullave të mbrojtjes së të dhënave. E pajisur me fuqi hetimore dhe zbatuese, kjo strukturë mbikëqyrëse luan një rol kyç në mbajtjen e integritetit të praktikave të mbrojtjes së të dhënave dhe në sigurimin e zbatimit të detyrimeve ligjore.

Në rast të një shkelje të të dhënave, ligji vendos kërkesa të rrepta për njoftimin e autoriteteve të rëndësishme dhe individëve të prekur, duke përcaktuar protokollet dhe kohëzgjatjen e qartë për njoftimin e shkeljeve dhe zvogëlimin e dëmeve të mundshme.

Duke pasur parasysh të gjitha këto, rezulton se objektivi kryesor i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave në Kosovë është vendosja e ekuilibrit ndërmjet mbrojtjes së të drejtave të privatësisë të individëve dhe procesimin e ligjshëm të të dhënave personale për qëllime të ndryshme ligjore.

⁷ Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave në Kosovë, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18616>

Ligji për Gjykatat

Ligji për Gjykatat⁸ përbën një ndër ligjet më të rëndësishme sa i përket kërkesës ligjore që ky Ligj vendos tek gjykatat për publikimin e vendimeve gjyqësore.

Neni 6, paragrafi 3 i këtij ligji përcakton se gjykatat duhet të publikojnë të gjitha aktgjykimet në faqen e tyre zyrtare të internetit, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe se Këshilli Gjyqësor duhet të nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij neni.

Edhe pse ky Ligj nuk përmban ndonjë kërkesë konkrete përkitazi me mbrojtjen e të dhënave personale, vet referimi tek legjislacioni pozitiv, konform së cilit duhet të bëhet publikimi i aktgjykimeve nënkupton se Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të respektohet përgjatë përpilimit të aktit nënligjor nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Pra, përveç mbrojtjes së të dhënave personale, ky nen nënkupton edhe përkushtimin për transparencë brenda sistemit gjyqësor. Synimi që qëndron pas kësaj kërkesë ligjore është të sigurojë transparencë në administrimin e drejtësisë, duke i lejuar qytetarët, profesionistët ligjor dhe publikun e gjerë të kenë qasje dhe të shqyrtojnë rezultatet e procedurave ligjore.

Kodi i Procedurës Penale (2022)

Kodi i Procedurës Penale,⁹ i miratuar në vitin 2022, përbën pjesën qenësorë të këtij Raporti dhe si rrjedhojë do t'i kushtohet një vëmendje më e posaçme. Në fakt, rregullimi që përcakton ky Kod përbën edhe vet arsyen e përpilimi të këtij raporti për shkak se përmban disa kërkesa ligjore në lidhje me publikimin e vendimeve gjyqësore në çështjet penale që qëndrojnë në raport të zhdrejtë me kërkesat ligjore të parapara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Nenet konkrete që kërkojnë vëmendje të posaçme janë neni 369 dhe 370 i Kodit të Procedurës Penale, të cilët përcaktojnë, si në vijim:

⁸ Ligji për Gjykatat, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302>

⁹ Kodi i Procedurës Penale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>

Neni 369

Përmbajtja dhe forma e aktgjykimit me shkrim

[...]

2. Hyrja e aktgjykimit përfshin: shënimin se aktgjykimi merret në emër të popullit, emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit dhe të anëtarëve të trupit gjykues dhe të procesmbajtësit, emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit, veprën penale për të cilën i akuzuari është dënuar dhe nëse ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, datën e shqyrtimit gjyqësor, nëse shqyrtimi gjyqësor ka qenë i hapur, emrin dhe mbiemrin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit, mbrojtësit të viktimave ose përfaqësuesit të viktimës të cilët kanë qenë të pranishëm në shqyrtim gjyqësor, datën e shpalljes së aktgjykimit të shqiptuar dhe datën e përpilimit të aktgjykimit.
3. Dispozitivi i aktgjykimit përfshin të dhënat personale të të akuzuarit dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për veprë penale për të cilën akuzohet, ose me të cilin lirohet nga akuzat për atë veprë apo me të cilin refuzohet aktakuza.

[...]

12. Për qëllimet e këtij neni, termi "të dhëna personale" përfshin informacionin personal si vijon: emrin, mbiemrin, emrin e qytetit të lindjes ose vendbanimit, funksionin publik të të pandehurit nëse ka dhe numrin personal. Kur numri personal nuk është në dispozicion, atëherë në vend të tij mund të përdoren data e lindjes, emri i njërit prind dhe vendlindja. Të dhënat personale shtesë, ashtu siç kuptohet ky term nga ligjet tjera, mund të shtohen vetëm nëse është e nevojshme për të shpjeguar rrethanat kontekstuale të veprave penale.
13. Përveç numrit personal, datës së lindjes, emrit të prindërve dhe vendlindjes, publikimi i të dhënave të tjera personale nga paragrafi 12 i këtij neni, nuk konsiderohet shkelje e privatësisë, për shkak të interesit të publikut për një gjyqësor të hapur dhe publik.

Neni 370

Publikimi i vendimeve gjyqësore

1. Në pajtim me Ligjin për Gjykatat, gjykatat obligohen të publikojnë të gjitha aktgjykimet online brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga nxjerrja e tyre.
2. Përjashtimisht, aktgjykimet nuk publikohen në rastet kur të miturit janë të përfshirë si palë, në rastet kur pretendohet se veprat penale janë kryer në kuadër të marrëdhënieve familjare apo në rastet e veprave penale kundër integritetit seksual. Nëse ndonjë ligj i veçantë përcakton konfidencialitetin në një procedurë respektive, dispozitat e atij ligji do të zbatohen lidhur me publikimin e aktgjykimeve të nxjerra në atë procedurë.
3. Në rastet kur një apo më tepër shqyrtime janë mbyllur për publikun për shkak të arsyeve të parapara në nën-paragrafët 1.1, 1.4, 3.1 apo 3.2 të nenit 289 të këtij Kodi, referencat në dëshmitë dhe provat tjera të përmendura në shqyrtim të tillë do të redaktohen nga aktgjykimi para publikimit.

Referencat tek të miturit dhe dëshmitë e tyre do të anonimizohen apo redaktohen, pa marrë parasysh nëse dëshmia e tyre është marrë në shqyrtim të mbyllur apo të hapur.

Për të lehtësuar këtë anonimizim/redaktim, aktgjykimet që përmbajnë referenca për një të mitur, dëshmia e një të mituri, ose informatat që janë marrë në shqyrtime të tilla të mbyllura, do të identifikojnë qartë, para publikimit, se cila pjesë e aktgjykimit hyn në një apo disa nga këto kategori.

4. Versioni i publikuar i aktgjykimit, përpara publikimit do të redaktohet në mënyrë që të mos përmbaj ndonjë referencë mbi numrin personal identifikues. Të gjitha të dhënat tjera të përcaktuara në paragrafin 12 të nenit 369 të këtij Kodi nuk do të redaktohen.
5. Gjyqtari i cili është i autorizuar për të nënshkruar aktgjykimin sipas nenit 368 të këtij Kodi, është i obliguar që të ndër marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që të përm-bushet obligimi ligjor për të publikuar aktgjykimin.
6. Gjykata po ashtu publikon aktvendimet me të cilat vendoset çështja penale.
7. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka kompetencë për të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij neni

Kjo pjesë e Raportit analizon nenin 369 dhe 370 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Këto dy nene vendosin një kuadër gjithëpërfshirës që rregullojnë publikimin e vendimeve gjyqësore dhe që sipas një interpretimi rrjedh se si rregull aktgjykimet publikohen, por ka dy momente të shmangies nga ky rregull e që nënkupton se

njëri ka të bëjë me përjashtimin e publikimit (pra kur aktgjykimet nuk publikohen) dhe rasti tjetër ka të bëjë me çështjen kur aktgjykimet publikohen por që duhet të jene të redaktuara / anonimizuara.

Këto tri elemente do të shtjellohen në vijim.

① Publikimi i aktgjykimeve

Gjykatat janë të obliguara që në pajtim me Ligjin për Gjykatat t'i publikojnë të gjitha aktgjykimet në platformat *online* brenda një periudhe të caktuar gjashtëdhjetë ditore nga data e nxjerrjes së tyre. Publikimi i këtyre vendimeve kërkon përfshirjen e disa informacioneve personale, veçanërisht të: a) emrit, b) mbiemrit, c) vendlindjes ose qytetit të vendbanimit, dhe d) funksionit publik të të pandehurit, nëse është e ditur.

Është e rëndësishme të theksohet se Kodi i Procedurës Penale (neni 369, paragraf 12 dhe 13) nuk i konsideron publikimin e këtyre të dhënave si shkelje të privatësisë duke pasur parasysh interesin e publikut për një gjyqësor të hapur dhe transparent, përjashtimisht të dhënat personale shtesë, duke përfshirë numrin personal, ose në mungesë të numrit, datën e lindjes, emrat e prindërve dhe vendin e lindjes, të cilat nuk duhet të publikohen në aktgjykime.

② Mos publikimi i aktgjykimeve

Derisa rregulli i vendosur në këtë Kod të Procedurës Penale është publikimi i aktgjykimeve, me disa të dhëna personale, përjashtim nga ky rregull që lidhet me publikimin e vendimeve gjyqësore ka të bëjë me çështjet që përfshijnë palët e mitura, rastet që kanë të bëjnë me krime brenda një marrëdhënieje familjare ose shkelje kundër integritetit seksual.

Sipas Kodit të Procedurës Penale, (neni 370.2), përjashtimisht, aktgjykimet nuk publikohen në rastet kur:

- 1) të miturit janë të përfshirë si palë,
- 2) në rastet kur pretendohet se veprat penale janë kryer në kuadër të marrëdhënieve familjare apo
- 3) në rastet e veprave penale kundër integritetit seksual.

Po ashtu, edhe nëse ndonjë ligj i veçantë përcakton konfidencialitetin në një procedurë respektive, dispozitat e atij ligji do të zbatohen lidhur me publikimin e aktgjykimeve të nxjerra në atë procedurë.

Rrjedhimisht, rezulton se Kodi i Procedurës Penale përjashton nga publikimi, pra nuk duhet që të publikohen gjitha rastet / lëndët e trajtuara nga:

1. Departamenti për të mitur;
2. Rastet kur pretendohet se veprat penale janë kryer në kuadër të marrëdhënieve familjare, saktësisht nenet e Kodit Penal që kanë të bëjnë me marrëdhënie familjare: 163 (3), 173 (1.3), 182 (2), 227 (4.9), 229 (3.9), 230 (3.9), 236, 237 deri në 248 (*Kapitulli Veprat Penale Kundër Martesës dhe Familjes*), grupi i neneve 313, 314, 315 (1.1), 320, 321 (1), 330 (1) dhe 332 ndërlidhur me nenin 335, 377 (3)¹⁰, 378 (3),¹¹ 379 (2),¹² 380 (5),¹³ ¹⁴; si dhe
3. Gjitha veprat penale që bien në Kapitulli XX – Veprat Penale Kundër Integritet Seksual.

Për këto aktgjykime që përjashtohen nga publikimi, i rekomandohet Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) që të kërkojë lëshimin e komunikatave publike, në ato raste kur ka interes publik, përmes së cilës njoftohet publiku në lidhje me i)

10 Kushdo që, përkundër që është në lidhje familjare me kryerësin e veprës penale si prind, fëmijë, bashkëshort ose bashkëshorte, vëlla ose motër, prind adoptues apo fëmijë i adoptuar ose person me të cilin kryerësi jeton në bashkësi jashtëmartesore, nëse nuk e lajmëron veprën penale si abuzimin e fëmijëve dhe dhunën në familje, mund të akuzohet për "Moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale", por që aktgjykimi potencial dënuet mbetet i përjashtuar nga publikimi pasi që kemi të bëjmë me vepër penale të kryer në kuadër të marrëdhënieve familjare, nëse denonçuesi me të akuzuarin janë i të njëjtës familje, por edhe viktima – se nëse viktima nuk është i së njëjtës familje a konsiderohet se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare?

11 Ibid. (Shënim: Logjika e njëjtë e sqarimit.)

12 Ibid.

13 Ibid.

14 Në Kodin Penal edhe vepra penale (417 – Konflikti i Interesit) i referohet anëtareve të familjes. Arsyeja pse nuk është vendosur edhe ky nen - edhe pse ndokush mund të thotë që vepra penale e Konflikt të Interesit, ku të përfshirë janë anëtarët e familjes bie në

të dënuarin, ii) veprën për të cilën është dënuar, iii) dënimin përkatës që i është shqiptuar.

③ Anonimizimi i aktgjykimeve

Derisa paragrafi 2 i nenit 370 të Kodit të Procedurës Penale flet për aktgjykimet që përjashtohen në tërësi nga publikimi, paragrafi 3 i nenit 370 përcakton rregullat në lidhje me anonimizimin e aktgjykimit.

Ky paragraf përcakton që çdo aktgjykim që ka të bëjë me seancat e mbyllura, siç përcaktohet me nenin 280 të Kodit të Procedurës Penale, duhet të redaktohet (anonimizohet).

Si rrjedhojë, në rastet kur seancat janë të mbyllura dhe kur kanë të bëjnë me: i) ruajtjen e sigurisë kombëtare dhe fshehtësisë zyrtare që mbrohet me ligj, ii) mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve bashkëpunues ose dëshmitarëve, mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve bashkëpunues ose dëshmitarëve, siç parashihet në Kapitullin XIII të Kodit të Procedurës Penale, apo kur seancat mbyllen për të iii) ruajtje konfidencialitetin e informacionit që do të rrezikohet nga publiku ose iv) mbrojtjen e jetës personale ose familjare të të akuzuarit, të dëmtuarit ose pjesëmarrësve tjerë në procedure, në këto aktgjykime referencat në dëshmitë dhe provat tjera të përmendura në shqyrtim të tillë do të redaktohen¹⁵ nga aktgjykimi para publikimit.

Po ashtu, në aktgjykime do të bëhet edhe redaktimi i çdo referencë për të mitur dhe dëshmitë e tyre, pavarësisht nëse dëshmia e tyre është marrë në shqyrtim të mbyllur apo të hapur. Për të lehtësuar këtë anonimizim/redaktim, aktgjykimet që përmbajnë referenca për një të mitur, dëshmia e një të mituri, ose informatat që janë marrë në

shqyrtime të tilla të mbyllura, do të identifikojnë qartë, para publikimit, se cila pjesë e aktgjykimit hyn në një apo disa nga këto kategori.

Për më tepër, para publikimit të aktgjykimit, numri i identitetit personal redaktohet/ anonimizohet, siç përcaktohet në nenin 370(4) të Kodit të Procedurës Penale. Pra në këto raste, ashtu siç parashihet në nenin 369 (paragrafët 12 dhe 13) përveç fshirjes së informacioneve që kanë të bëjnë me të dhënat personale, nga aktgjykimi fshihen edhe pjesa e dëshmimeve apo informacioneve tjera konfidenciale.

Më kodin e Procedurës Penale, saktësisht me nenin 370, paragrafin 6, edhe aktvendimet për hedhjen e aktakuzave dhe pushimin e procedurës publikohen me të njëjtën logjikë sikur aktgjykimet, pra të gjitha publikohen, përjashtimisht nëse aktakuzat kanë të bëjnë me veprat penale të pacaktuara me nenin 370 (2), ato aktvendime për hedhjen e aktakuzave nuk publikohen.

Dhe në fund, Kodi i Procedurës Penale siguron që publikimi i vendimeve gjyqësore të përputhet me parimet e transparencës dhe mbrojtjes së privatësisë. Për më tepër edhe Kodi parasheh obligimin për KGJK-në në nxjerrjen e aktit nënligjor për zbatimin efektiv të këtyre dispozitave, siç parashihet me nenin 370, paragrafi 7.

Kodi Penal (2019)

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, sa i përket publikimi të aktgjykimeve nuk është se mbulon ndonjë pjesë të rëndësishme, ashtu siç këtë e bën Kodi i Procedurës Penale. Megjithatë, edhe Kodi Penal, saktësisht neni 59 (2.7) dhe neni 66 ka paraparë disa masa shtesë përkitazi me dënimet plotësuese, që përfshijnë urdhrin për publikimin e aktgjykimit.

domenin e marrëdhënieve familjare - rekomandohet fuqishëm që ky nen të mos përfshihet në këtë përjashtim, pasi që vepra penale kryhet me qëllim të përfitimit të kryesit/ funksionarit publik dhe anëtarit të familjes dhe në asnjë rast anëtari i familjes është viktime siç besohet të jetë qëllimi i ligjvënësit për të cilën ka bërë përjashtimin e këtyre veprave penale nga publikimi.

¹⁵ Në gjuhën angleze me termin 'redaktim' kuptohet fshirja e informacionit të ndjeshëm ose konfidencial në vendimet gjyqësore. Redaktimi mund të bëhet përmes redaktimit manual duke përdorur marker të zi ose redaktim dixhital duke përdorur mjete softuerike. Qëllimi i të dy opsioneve është bërja e informacioneve të padukshme për publikun.

Ndonëse, Kodi i Procedurës Penale si dhe Ligji për Gjykata vendosin obligimin ligjor që të gjitha aktgjykimet të publikohen, Kodi Penal, shkon edhe një hap më tutje duke paraparë si dënim plotësues urdhrin për publikimin e aktgjykimit. Ky dënim plotësues ka për qëllim aktgjykimi të bëhet publik edhe në media / portale përmes publikimit në gazetë apo të transmetohet në radio ose televizion, në mënyrë që ajo vendimarrje gjyqësore të merr jehonën e merituar publike.

Pra ky nen ka për qëllim që të ua bënë të njohur publikut, kryesit e këtyre veprave penale, dhe që njëherit është në funksion të mbrojtjes së shoqërisë. Në anën tjetër, mund që të jetë edhe në funksion të riparimit të imazhit nëse ndonjë i akuzuar është shpallur i pafajshëm. Mediat janë të detyruara që ta publikojnë këtë aktgjykim në mënyrë që publiku të marrë njohuritë e duhura në lidhje me të.

Do të ishte e rrugës që gjyqtarët të fillojnë së shqiptuari këtë dënim plotësues në masë më të madhe, sidomos tek veprat që janë më të ndjeshme, në mënyrë që të kenë efektin parandalues dhe informues tek opinioni publik. Për më tepër, do të ishte e këshillueshme që gjyqtarët të shqiptojnë urdhrin për publikimin e aktgjykimit si dënim plotësues për raste më të ndjeshme dhe të rënda siç janë rastet e pedofilisë apo dhunuesve serikë. Edhe pse mbetet në diskrecion të gjyqtarit të çështjes të vendos shqiptimin e dënimit plotësues dhe të urdhërojë publikimin e aktgjykimit, një dokument që do të lëshohej nga ana e KGJK-së e që do të përmbante parime udhëzuese rreth shqiptimit të këtij dënimi plotësues, do të përbënte mjet ndihme shtesë për gjyqtarët që gjykojnë raste të tilla.

Udhëzimi Administrativ 04/2019 për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara

KGJK ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ 04/2019 lidhur me publikimin e aktgjykimeve të përpunuara. Ky udhëzim zëvendëson Udhëzimin e mëparshëm Administrativ (2016) për anoni-

mizimin dhe publikimin e aktgjykimeve të formës së prerë të gjykatave. Udhëzimi rregullon procedurat e përpunimit të të dhënave, duke përcaktuar se të dhënat personale në aktgjykime duhet të anonimizohen përpara publikimit për të parandaluar identifikimin e individëve të përmendur në aktgjykim.

Të dhënat personale specifike që i nënshtrohen përpunimit brenda aktgjykimit përfshijnë, por nuk kufizohen në: emër dhe mbiemër, adresë, datë dhe vend të lindjes, numrin identifikues të letërnjoftimit ose pasaportës, detajet e patentë shoferit, targat e automjeteve, numër të dokumenteve të tjera personale, numër të biznesit, numër fiskal të kompanive tregtare, adresë emaili dhe adresë/faqe të internetit ose rrjeteve sociale.

Në sferën e çështjeve penale, përpunimi i aktgjykimit përfshinë përpunimin e të dhënave sa i përket palëve të ndryshme si: të akuzuarit, individët e dënuar, personat e lidhur ngushtë me të akuzuarin, i dëmtuari, dëshmitarët, ekspertët e gjykatës, përkthyesit e gjykatës, punonjësit socialë, psikologët dhe pjesëmarrësit e tjerë që veprojnë në cilësinë e tyre zyrtare gjatë gjykimit.

Në çështjet civile dhe ekonomike, përpunimi i vendimeve përfshinë palët ndërgjyqësore (persona fizikë dhe juridikë), palët e njohura sipas ligjeve në fuqi, përfaqësuesit e autorizuar, përfaqësuesit ligjorë, aksionarët, anëtarët e bordit drejtues, përfaqësuesit e punonjësve, trashëgimtarët, dëshmitarët, ekspertët gjyqësor, përkthyes gjyqësor, punonjës socialë, psikologë dhe individë të tjerë që marrin pjesë në gjykim në cilësinë e tyre zyrtare.

Në mënyrë të ngjashme, në çështjet administrative, përpunimi i vendimeve i përket paditësit, të paditurit, përfaqësuesve ligjorë, ekspertëve, përkthyesve gjyqësorë, punonjësve socialë dhe individëve të tjerë që marrin pjesë në procedurat ligjore administrative në cilësinë e tyre zyrtare.

Edhe pse Kodi i Procedurës Penale ka hyrë në fuqi në shkurt 2023, KGJK ende nuk ka bërë ndry-

shimet e duhura në Udhëzimin Administrativ për të vendosur një përputhshmëri të plotë ndërmjet kërkesave të reja ligjore të parapara në Kod të Procedurës Penale me obligimet e gjykatave sa i përket publikimit, saktësisht mos anonimizimit të aktgjykimeve.

Ligji për Sistemin Qendror të Evidencës Penale

Ligji Nr. 08/L-194 për Sistemin Qendror të Evidencës Penale të Kosovës¹⁶ vendos kuadrin ligjor për themelimin, menaxhimin dhe operimin e Sistemit Qendror të Evidencës Penale në Kosovë. Qëllimi kryesor i ligjit është të krijojë një sistem të centralizuar për ruajtjen e të dhënave penale të sakta dhe të përditësuara në Kosovë. Ky ligj, themelon Sistemin Qendror të Evidencës Penale, që nënkupton një regjistër qendror për ruajtjen dhe menaxhimin e informacionit më të dhënat penale.

Për më tepër, ky ligj përcakton procedurat për mbledhjen, regjistrimin dhe mirëmbajtjen e informacionit të regjistrave penale dukë saktësuar llojet e të dhënave që duhet të përfshihen në sistemin qendror të evidencës penale, si detajet personale të kryesve të krimeve, detajet e veprave penale, vendimet gjyqësore dhe informacionin tjetër të rëndësishëm. Qasja në këto informacione është zakonisht e kufizuar për individët dhe institucionet e autorizuara, si agjencitë e zbatimit të ligjit, autoritetet gjyqësore, institucionet qeveritare dhe përdoruesit e autorizuar të tjerë dhe mund të jepet për qëllime specifike, si hetimet penale, verifikimit për qëllime të punës, ose procedura tjera ligjore.

Për fund, ligji përfshin dispozita për të mbrojtur të drejtat e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave të individëve ku informacioni i tyre është i ruajtur. Ai përcakton masat për të garantuar konfidencialitetin, integritetin dhe sigurinë e të dhënave kriminale, duke përfshirë kufizimet

në qasjen e paautorizuar, përdorimin dhe zbulimin e këtij informacioni si dhe vendos mekanizma zbatimi dhe sanksione për shkeljet e dispozitave të tij. Kjo mund të përfshijë sanksione për qasjen e paautorizuar në regjistrat kriminale, keqpërdorimin e informacionit, mosrespektimin e kërkesave për mbrojtjen e të dhënave, ose shkeljet e tjera të ligjit.

Është me rëndësi të theksohet se ky ligj përjashton mundësinë e qasjes në të dhënat e evidencës penale për publikun e gjerë, për shkak të ndjeshmërisë së lartë të këtyre të dhënave, derisa siç u cek më lartë Kodi i Procedurës Penale parasheh që publikimi i aktgjykimeve të përfshijë disa të dhëna personale. Duke qenë se qëllimet e këtyre dy akteve nënligjore janë në shpërputhje, pra deri sa njëri ka synim që të dhënat e historikut kriminal të individëve të mbesin të mbyllura për publikun e gjerë dhe të jenë në dispozicion vetëm për një sërë institucionesh, në anën tjetër Kodi i Procedurës Penale kërkon që aktgjykimet jo vetëm të behën publike, por edhe të përmbajnë disa të dhëna personale, që është në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe frymën e Ligjit për Sistemin Qendror të Evidencës Penale. Ajo çka mund të konkludohet, nga një analizë sipërfaqësore, është që derisa këto dy akte ligjore kanë qëllime kontradiktore, atëherë rekomandimi që del nga ky raport është që aktgjykimet që publikohen nga gjyqësori, në bazë të Kodit të Procedurës Penale, të jenë në dispozicion të publikut vetëm deri sa nuk arrihet rehabilitimi, qoftë gjyqësor qoftë ai ligjor i të dënuarit, dhe mbas këtij afati Këshilli Gjyqësor, respektivisht gjykata të bëjnë fshirjen nga ueb faqja zyrtare apo redaktimin e thelle të aktgjykimit, me qëllim që të ketë një harmonizim të qëllimeve që të dyja ligjet kanë si objektiv përfundimtar.

¹⁶ Ligji për Sistemin Qendror të Evidencës Penale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=84234>

Rekomandime

Meqenëse Ligji për Gjykata dhe Kodi Procedurës Panel obligon KGJK-në të nxjerrë akt nënligjor për publikimin e aktgjykimeve, saktësisht obligon gjykatat që të publikojnë të gjitha aktgjykimet në faqen e tyre zyrtare të internetit, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit në pajtim me legjislacionin në fuqi. Rekomandimet në vijim i drejtohen KGJK-së me qëllim apo me rekomandimin kryesor që Udhëzimi i radhës për publikimin e aktgjykimeve të strukturohet në katër (4) pjesë, dhe i cili do të trajtonte ndaras karakteristikat e aktgjykimeve përkatëse për secilën fushë ndaras, në atë: panele, civile, administrative dhe ekonomike (komerciale).

Në vijim, Lëvizja FOL do të paraqesë rekomandimet sa i përket publikimit të aktgjykimeve për secilën fushë veçmas.

Rekomandimet në Fushën Penale

Lëvizja FOL rekomandon KGJK-në që në Udhëzimin e ri Administrativ për publikimin e aktgjykimeve të merr në konsideratë këto rekomandime sa i përket aktgjykimeve penale, të cilat derivojnë nga legjislacioni penal pozitiv i Kosovës.

① Publikimi/Redaktimi i aktgjykimeve: Të gjitha aktgjykimet penale të publikohen sipas nenit 369(12 dhe 13) dhe nenit 370. Çështjet që kanë të bëjnë me publikimin, respektivisht përjashtimin nga publikimi apo redaktimin e aktgjykimeve janë shtjelluar në masë më të madhe në këtë raport, në pjesën ku janë analizuar kërkesat ligjore të Kodit të Procedurës Penale dhe rekomandohet që ato të merren për bazë gjatë përpilimit të Udhëzimit të ri Administrativ.

② Kohëzgjatja e publikimit: Rekomandojmë KGJK-në që në Udhëzimin Administrativ të vendosen rregulla strikte sa i përket mbajtjes në ueb faqe të aktgjykimeve, më saktësisht rekomandojmë që aktgjykimet të qëndrojnë të publikuara në ueb faqe të KGJK-së deri sa dënimet e personave të dënuar të fshihen nga evidenca penale. Pas rehabilitimit gjyqësor/ ligjor aktgjykimet duhet të redaktohen plotësisht apo të hiqen nga ueb faqja zyrtare dhe të mos jenë në dispozicion të publikut me të dhëna të plota.

③ Me qëllim që të ruhet transparencja në vendimmarrje dhe të evidentohet performanca e gjyqtarëve, rekomandojmë KGJK-në që në rastet kur i dënuari fshihet nga evidenca penale, aktgjykimi përkatës t'i nënshtrohet redaktimit të thellë, pra të fshihen të gjitha të dhënat personale dhe rrethanat tjera përmes së cilave mund të bëhet dallimi apo identifikimi i drejtpërdrejt ose indirekt i individit / të dënuarit.

Lëvizja FOL rekomandon KGJK-në që gjatë përpilimit të udhëzimit të ri të shqyrtojë dhe vendosë edhe për çështjet si në vijim:

- Si të vepohet me aktgjykimet që janë me dënime me gjobë dhe që nuk evidentohen në evidencë penale, pra deri kur duhet që ato të mbesin të publikuara në ueb faqen zyrtare të gjykatave?
- Si të vepohet me aktgjykime që kanë më shumë se një të dënuar, e njërit i është fshirë dënimi në Evidencë Penale e tjerëve ende jo? A të mbetet aktgjykimi i plotë në ueb faqen deri në fshirjen e të dënuarit të fundit nga Evidenca Penale? Lëvizja FOL konsideron se opsioni më ideal është që kurdo herë që njëri nga subjektet e dënuara fshihet nga Evidenca Penale, i njëjti aktgjykim të redaktohet ashtu që të fshihen tërësisht të dhënat e atij të dënuari.

Për fund, Lëvizja FOL rekomandon që Udhëzimi i ri Administrativ të respektojë në tërësi kërkesat ligjore të Kodit të Procedurës Penale, sa i përket rasteve kur nuk publikohen apo rastet kur anonimizohen aktgjykimet, si dhe rastet kur duhet të publikohen aktvendimet e marra në procedurë penale, ashtu siç janë evidentuar në këtë raport në pjesën ku është analizuar Kodi i Procedurës Penale.

Rekomandimet në Fushën Civile

Lëvizja FOL rekomandon që:

- 1 Të publikohen aktgjykimet nga lëmi civil, por që të dhënat e palëve ndërgjyqësore, dëshmitarëve, ekspertëve, etj të jenë të anonimizuara.

- 2 Të mos publikohen aktgjykimet nga seancat e mbyllura për publikun siç janë çështjet statusore (i.e. divorci) dhe ato që përhijjnë fëmijët (alimentacioni, njohja e atësisë, etj).

Lëvizja FOL rekomandon KGJK-në që gjatë përpilimit të udhëzimit të diskutohet edhe në lidhje me kohëzgjatjen e të qëndruarit në ueb të këtyre aktgjykimeve.

Rekomandimet në Fushën Administrative

Lëvizja FOL rekomandon që të publikohen të gjitha aktgjykimet administrative me të dhëna të palëve, dëshmitarëve, ekspertëve, etj.

Lëvizja FOL rekomandon KGJK-në që gjatë përpilimit të udhëzimit të diskutojë dhe vendosë edhe në lidhje me kohëzgjatjen e të qëndruarit në ueb të këtyre aktgjykimeve.

Rekomandimet në Fushën Ekonomike (Komerçiale)

Lëvizja FOL rekomandon që të publikohen të gjitha aktgjykimet komerciale me të dhëna të palëve, dëshmitarëve, ekspertëve, etj.

Lëvizja FOL rekomandon që në procedurën gjyqësore ku zhvillohen kontestet komerciale, Gjykata të konstatojë se cilat janë sekretet afariste të subjektit ekonomik. Nëse këto sekrete duhet të jenë pjesë përbërëse e vendimit gjyqësor, atëherë për qëllim të publikimit ato sekrete afariste anonimizohen duke dhënë përshkrimin "Sek af." dhe shkronja e parë iniciale.

FOL

